

**Njoftim për përqendrimin me të cilin Dunapack Packaging Hellas Single Member
Societe Anonyme, Greqi do të fitojë kontrollin mbi El-Pack Single Member Societe
Anonyme Packaging Products, Greqi**

(Lënda nr. 08-124/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 11.08.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftimi për përqendrim me të cilin Dunapack Packaging Hellas Single Member Societe Anonyme, me seli të regjistruar në adresën Rahi, Schimatari, Tanagra, Beoti, 32009, Greqi do të fitojë kontrollin e vetëm mbi El-Pack Single Member Societe Anonyme Packaging Products, me seli të regjistruar në adresën Leoforos Athinon 31-33, Athinë, Greqi përmes shitblerjes së aksioneve.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Aktiviteti kryesor i Dunapack Packaging Hellas Single Member Societe Anonyme konsiston në prodhimin/tregtimin e kartonit të valëzuar dhe kutive të valëzuara. Shoqëria merret me përpunimin e letrës ose lëndëve të tjera të para për prodhimin e produkteve të letrës dhe llojeve të tjera të ngjashme të mallrave, plasmanin e mallrave të tilla dhe shitjen me shumicë ose pakicë të mallrave prej letre përmes dyqaneve të marra me qira nga shoqëria për këtë qëllim ose me porosi nga palët e treta ose përmes pjesëmarrjes në prokurime publike dhe kryerjen e punëve të lartpërmendura dhe marketingun e letrës, përfaqësimin e shoqërive vendase ose të huaja dhe furnizimin e tyre, importin e lëndëve të para dhe produkteve të gatshme dhe çdo punë të ngjashme.

Dunapack Packaging Hellas Single Member Societe Anonyme është pjesë e Grupit Prinzhorn, një grup i shoqërive të kontrolluara nga anëtarët e familjes Prinzhorn. Grupi Prinzhorn nuk ka prani fizike në Maqedoninë e Veriut, por divizioni i tij i letrës për paketim dhe divizioni i paketimit shesin produkte në Maqedoninë e Veriut deri në një masë të caktuar (por të kufizuar). Grupi Prinzhorn nuk ka subjekte të lidhura në Maqedoninë e Veriut.

Aktiviteti kryesor i El-Pack Single Member Societe Anonyme Packaging Products është prodhimi industrial dhe tregtimi i të gjitha llojeve të ambalazheve dhe lëndëve të para për paketim, prodhimi industrial dhe tregtimi i letrës dhe kryerja e veprimtarive të ngjashme.

El-Pack Single Member Societe Anonyme Packaging Products aktualisht merret me: (a) prodhimin dhe tregtimin e letrës së ricikluar për paketim (në tekstin e mëtejme: "biznesi i letrës"); dhe (b) prodhimin dhe tregtimin e letrës së valëzuar dhe kartonit të valëzuar, si dhe kontejnerëve për letër dhe karton (në tekstin e mëtejme: "biznesi i paketimit"). Me përqendrimin në fjalë, Dunapack Packaging Hellas Single Member Societe Anonyme do të fitojë vetëm biznesin e paketimit të El-Pack Single Member Societe Anonyme Packaging Products.

El-Pack Single Member Societe Anonyme Packaging Products nuk ka prani të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për nevojat e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu përkatës të përkufizohet si tregu për prodhimin dhe shitjen e kartonit të valëzuar dhe tabelave dhe kutive të valëzuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që t'i dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi

14.08.2026

Shkup